



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Vitia

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, nenit 36.1 dhe 36.2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seance e mbajtur më 29.04.2015, aprovon këtë:

V E N D I M
PËR ÇAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E TREGUT TË KAFSHËVE NË ZONËN
KADASTRALE DROBESH

Neni 1.

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë APROVON Vendimin për caktimin e lokacionit për vendosjen e tregut të kafshëve në fshatin Drobesh të Komunës së Vitisë.

Neni 2.

Vendi - lokacioni për vendosjen e tregut të kafshëve është në Zonën Kadastrale në Drobesh, përkatësisht në parcelën kadastrale me numër 470-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 4740m² e cila është në pronësi të Komunës së Vitisë.

Neni 3.

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset: Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi, Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë e Komunës së Vitisë.

Neni 4.

Ky Vendim, hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Drejtorisë për kadastër,
2. Drejtorisë për Financa,
3. Drejtorisë për Shërbime Publike,
4. Shërbimit të Kuvendit dhe
5. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT
Naim Pira

